

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur në çështjen juridike të paditësve: [“E...”], me seli në Gjakovë; [E.SH] nga Gjakova dhe [F.I.P], po ashtu Gjykova të cilën i përfaqëson sipas autorizimit [A.R], avokat nga Gjakova, kundër të paditurës [“B...”], me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [R.K], për anulim te neneve 1, 3 dhe 5 të kontratës së kredisë, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të datës 24.01.2019, me datën 28.01.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet kërkesëpadija e paditësve [“E...”], me seli në Gjakovë; [E.SH] nga Gjakova dhe [F.I.P], po ashtu nga Gjakova si e bazuar dhe Vërtetohet se neni 5 i kontratës me numër ..., të datës 08.12.2004, me të cilin është kontaktuar kamata ndëshkuese, është NUL dhe nuk prodhon efekt juridike ndërmjet palëve kontraktuese.

II. Detyrohet pala e paditur [“B...”], me seli në Prishtinë, që pagesat e llogaritura në këtë raport kontraktues në emër kamatës ndëshkuese në shumën prej 508,00 €, ta llogaritë si pagesë e borxhit kryesor dhe kamatës së rregullt të përcaktuar me kontratë, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësit [“E...”], me seli në Gjakovë, [E.SH] nga Gjakova dhe [F.I.P], po ashtu nga Gjakova, me datën 24.02.2017, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi, kundër të paditurës [“B...”], me seli në Prishtinë, për anulimin e neneve 1, 3 dhe 5 të kontratës së kredisë.

I autorizuari i paditësit si në padi ashtu edhe gjatë seancave dëgjimore ka theksua me të paditurën kanë hyrë në raport juridik – detyrimorë, përmes lidhjes së kontratës me numër Ku përmes kësaj kontrate paditësi i parë dhe paditësi i dytë kanë marrë kredi nga e paditura në shumën prej 150,000.00 euro, të cilën shumë e kanë tërhequr me dy kiste, ku shumën prej 100,000.00 €, e kanë tërhequr në momentin e lejimit të kredisë, ndërsa shumën prej 50,000.00 €, e kanë tërhequr pas një periudhe me shumë se një vit. Ndërsa, paditësi i tretë në cilën garantuesit e ka lënë në hipotekë palujatëshmërinë e tij, si mjet i sigurimit të ekzekutimit të kontratës, ndërsa afati i kthimit të kredisë ka qenë prej 24 muajve. Duke shtuar, se me kontratë përveç kamatës së rregullte është përcaktuar edhe kamata ndëshkuese prej 0.2 e shumës së tërhequr për çdo ditë vonesë në kthimin e kredisë. Po ashtu ka theksuar se ka kryer pagesa në emër të kamatës ndëshkuese edhe kjo kamatë e përcaktuar në kontratën e kredisë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, e po ashtu edhe me rregullat e BQK-së, në lidhje me kamatat, dhe pas marrjes së mendimit dhe konstatimit të ekspertizës financiare në seancë e datës 24.01.2019 paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadiës ku i ka propozuar gjykatës që të marrë aktgjykim me të cilën nenin 5 të kontratës për kredinë me numër ..., ta shpallë nule dhe shumën të cilën e ka inkasuar e paditura në emër të

kamatës ndëshkuese ta konsideroj si pagesë të borxhit kryesorë, dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar përmes paditës, mirëpo nuk i ka specifikuar

I autorizuari i paditurit përmes përgjigjes në padi dhe gjatë seancave dëgjimore e ka kontestuar kërkesëpadinë, ndër të tjera ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me gjyqëvarësi, ngase, pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, është zhvilluar procedura përmbarimore në lidhje me detyrimet e paditësve nga kjo kontratë e kredisë dhe se kjo lëndë është duke u trajtuar nga Gjykata e Apelit me ankesë. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësit vetë në vullnetin e tyre të lirë e kanë nënshkruar kontratën ku janë dakorduar për të gjitha pjesët e kontratës, andaj edhe kanë për detyrim që t'i përmbushin detyrimet e marra me këtë kontratë, dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzoj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar .

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete, gjykata në procedurën e nxjerrjes së provave gjatë shqyrtimit kryesorë të datës 24.01.2019, administroj si provë kontratën e kredisë të datës 08.12.2014, shërbimime kredive konkluzionin me numër P.nr., të datës 19.07.2016, kontratën për hipotekën të datës 18.08.2004, procesverbali me numër ..., të datës 05.09.2016, të Përmbaruesit Privat, propozimin për shitjen e paluatjshmërisë të datës 10.11.2006, konkluzionin e Gjykatës Themelore në Gjakovë CP.nr.518/14, të datës 14.07.2016, kundërshtimin e datës 01.08.2016, me të gjithë dokumentacionin në procedurën përmbarimore, certifikatën e paditësit me numër ..., ekspertizën gjyqësore financiare të datës 05.12.2018, të punuar nga eksperti [F.K], plan amortizimi i kredisë nga Banka të datës 30.12.2004, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër ..., të datës 06.06.2016.

Pas shqyrtimit dhe çmuarjes me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, dhe konstatimit të fakteve jo kontestuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nuk ishte kontestuese se paditësit dhe e paditura kanë krijuar raporte juridike detyrimor nga kontrata për kredinë me numër ..., ku në këtë raport kontraktues, paditësit ["E..."] dhe, [E.SH], kanë pasur rolin e kredimarrësit, ndërsa, paditësi [F.I.P], ka pasur rolin e garantuesit. Në anën tjetër e paditura ka pasur rolin e kredi dhënësit.

Nuk ishte kontestuese se në këtë raport kontraktues paditësit ["E..."] dhe, [E.SH], nga e paditura kanë marrë kredinë në shumën prej 150,000.00 €, ndërsa paditësi [F.I.P], përmes lënies në hipoteke të paligjshmërisë së tij ka garantuar kthimin e kredisë. Po ashtu nuk ishte kontestuese se afati i kthimit të kredisë ka qenë 24 muaj dhe se kamata e rregullt për kredinë ka qenë në shkallën prej 13 %.

Kontestuese në këtë çështje juridike kontestimore ishte çështja e kamatës ndëshkuese, e parapar në nenin 5 të kontratës së lartë cekur.

Pas shqyrtimit të provave të lartë cekura gjykata ka konstatuar faktin se, palët kontraktuese përveç kamatës së rregullt palët kanë kontraktuar edhe kamatën ndëshkuese për vonesë, përkatësisht në nenin 5 të kontratës është e përcaktuar detyrimi i paditësve për pagesën e shumës prej 02 % të shumës së pa paguar për çdo ditë vonese në kthimin e kredisë.

Gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerr provën me anë të ekspertizës financiare ku nga ekspertiza financiare e punuar nga eksperti [F.K.] dt.05.12.2018 ka rezultuar se nga vlera e kredisë së lejuar prej 150,000.00 €, paditësit kanë paguar shumën prej 70,035.45 €, në emër të kryegjësë (borxhit kryesor), shumën prej 15,405.71 €, në emër të kamatës së rregullt 13 %, ndërsa në emër të kamatës ndëshkuese ka paguar shumën prej 508,00 €.

Gjykata e ka shqyrtuar raportin e ekspertizës financiar dhe ka ardhur në përfundimin se raporti i ekspertizës është i punuar në mënyrë profesionale, në masë të mjaftueshëm është i arsyetuar mirë, është në përputhje edhe me provat tjera të lëndës.

Bazuar në të lartëcekurat gjykata vlerësoi se dispozita kontraktuese kontestuese, përkatësisht Neni 5 i Marrëveshjes Kreditore me nr. ..., është në kundërshtim me dispozitën e nenit 270 paragrafi 3 të LMD-së sipas së cilës ndëshkimi kontraktues nuk mund të kontraktohet për detyrimet në të holla. Meqenëse kjo dispozitë është e natyrës imperative, gjykata vlerëson se kamata ndëshkuese si ndëshkim i kontraktuar, bie në kundërshtim me normën imperative dhe nuk mund të ketë efekt juridik andaj të njëjtin konform nenit 103 të LMD-së, e konsideroi dispozitën kontraktuese NULE. Prandaj gjykata e vendosi si në pikën e I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, paditësit kanë kërkuar që pagesa e kryer në emër të kamatës ndëshkuese të llogaritet si pagesë e borxhit kryesor. Gjykata duke u bazuar në nenin 104 dhe 105 të LMD-së, vendosi si në paragrafin II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë duke detyruar të paditurën që shumën e pagesës së pranuar prej 508.00 €, nga paditësit në emër të kamatës ndëshkuese, ka llogarisë si pagesë të borxhit kryesor.

Pretendimet e palës së paditur e cila ka theksuar se kontrata është lidhur me vullnetin e lirë të palëve, dhe se e njëjta krijon detyrim për palët, gjykata vlerësoi si të pa bazuar nga fakti se kur një dispozitë kontraktuese parasheh detyrim i cili bie ndesh me një normë imperative, dispozita kontraktuese nuk ka efekt juridike pavarësisht faktit se kontrata është lidhur me vullnetin e palëve kontraktuese. Gjykata potencon se kontraktimi i një detyrimi të tillë nuk përbën veprim me të cilin palët mund të disponojnë lirisht, ngase është në kundërshtim me normat imperative.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata e ka bazuar në dispozitën e nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale. Andaj duke u bazuar në të lartë cekurat dhe duke ju referuar nenit 270 paragrafi 3 të dhe nenit 103 të LMD lidhur me nenin 143 dhe 463 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
III.EK,.nr.100/2017, me datën 28.01.2019

Gjyqtarja,
Franciska Zhitia-Vineri

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.